



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 144, datë 14.12.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË SISTEMIM**  
**FILLESTAR NË APARTAMENTET E LIRA NË PALLATET E NDËRTUARA NË**  
**ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM-në nr.814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, VKM-në nr. 504, datë 27.07.2022 “Për kalimin të Fondi Shqipëtar i Zhvillimit dhe bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë dhe Krujë të njësive të banimit, të shërbimit, të ndërtimit nën tokë dhe njësive teknike në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë dhe Krujë” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Zëvendëskryetari i bashkisë i cili mbulon Drejtorinë Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës emërore të familjeve që përfitojnë sistemim fillestar në pallatet e ndërtuara në zonën e re për zhvillim në Njësine Admnsitrative Manëz, që kanë mbetur të pastrehë nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019, pas shembjes së objektit dhe banesave që posedonin, sipas tabelës së mëposhtme:


Nr.	Nr. Aplikimi	Emër	Atësi	Mbiemër	Çertifikata Familjare Data Aplikimit
1	24686	GANI	HASAN	SHEHU	2 PERSONA
2	10711	SAVA	MAHMUT	PRIFTI	2 PERSONA
3	19426	ARBEN	HAXHI	STANA	2 PERSONA
4	19496	PETRIT	HAMIT	SHEHI	5 PERSONA
5	13481	XHEVDET	MURAT	GJOKA	5 PERSONA
6	10679	GJINOVEFA	FERIT	SALIAJ	2 PERSONA
7	8842	XHUMAJE	BAJRAM	LIKA	2 PERSONA
8	8828	BEHARE	HAXHI	PERLEKA	2 PERSONA
9	10652	FISNIK	ALI	HARHULLA	3 PERSONA
10	5428	YLLI	ISA	QOSE	3 PERSONA
11	19611	ALFRED	XHEVIT	XHIJA	3 PERSONA
12	19521	ASTRIT	XHEVIT	XHIJA	3 PERSONA
13	19669	ARJAN	XHEVIT	XHIJA	4 PERSONA
14	19461	HUME	SADIK	XHIJA	3 PERSONA
15	10743	BUKURIJE	MEHMET	KAPEDANI	5 PERSONA

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**




**U shpall sot me datë 15.12.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 933 / prot.

Durrës, më 20.12 .2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.144 datë 14.12.2022 “Për miratimin e listës emërore të familjeve që përfitojnë sistemin fillestar në apartamentet e lira në pallatet e ndërtuara në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative Manëz.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

